

Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor, 2013

Tiranë, më 06 janar 2014: Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2013, arriti 116,2 % kundrejt muajit Dhjetor 2007 (Dhjetor 2007=100).

Në muajin Dhjetor 2013 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 1.9 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 2,4 %. Krahasuar me muajin Dhjetor 2012, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Pije alkoolike dhe duhan" me 4,2 % pasuar nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 3,5 %, "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 3,3 %, "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me 2,3 %, etj. Ndërsa ulja me e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Komunikimi" me 2,9 % pasuar nga grupi "Shëndeti" me 1,5 %, "Transporti" me 1,2 % etj.

Rritja vjetore në muajin Dhjetor është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 1,4 pikë përqind. Në këtë grup çmimet e zarzavateve janë rritur me 23,2 % dhe çmimet e frutave me 13,2 %. Rritja e çmimeve të grupit "Pije alkoolike dhe duhan" ka kontribuar me 0,2 pikë përqind në ndryshimin vjetor. Krahasuar me një vit më parë çmimi i duhanit u rrit me 8,0 %. Çmimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" kanë kontribuar gjithashtu me 0,4 pikë përqind. Në këtë grup çmimet e materialeve për mirëmbajtjen e shtëpisë u rritën me 2,6 % dhe çmimi i ujit të pijshëm me 1,8 %.

Çmimet e ulëta të grupit "Veshje dhe këpucë" kanë ndikuar me - 0,2 pikë përqind në ndryshimin vjetor. Në këtë grup çmimet e veshjeve u ulën me 3,9 % dhe çmimet e këpucëve me 2,1 %.

Në Dhjetor 2013 ndryshimi mujor i indeksit është 1,7 %. Rritja mujore e çmimeve është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 1,5 pikë përqind. Çmimet e zarzavateve u rritën me 26,1 %, vezëve me 9,1 %, frutave me 3,6 %, duhanit me 2,3 %. Çmimet e larta të grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" ndikuan me 0,1 pikë përqind në ndryshimin mujor. Në këtë grup çmimi i gazit të lëngshëm u rrit me 6,0 % dhe çmimi i druve të zjarrit me 4,1 %.

Nga ana tjetër çmimet e ulëta të grupit "Transporti" kanë ndikuar me - 0,01 pikë përqind në ndryshimin mujor. Çmimi i naftës u ul me 0,2 % dhe çmimi i benzinës me 0,1 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit





Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2007=100

%

Kodi	Grupet	Peshat	12-12	01-13	02-13	03-13	04-13	05-13	06-13	07-13	08-13	09-13	10-13	11-13	12-13
Gjithsej		100,0	114,1	115,2	116,5	116,8	116,6	115,5	114,8	113,8	113,7	114,6	114,8	114,2	116,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	39,3	121,1	123,8	127,0	128,6	128,1	124,9	123,1	121,1	120,7	122,6	122,4	120,7	125,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,6	128,9	128,8	129,2	129,1	129,0	129,7	129,5	129,5	129,3	129,4	129,8	132,6	134,4
3	Veshje dhe këpucë	5,1	88,6	87,9	87,3	87,1	87,0	86,7	85,6	85,0	84,9	85,1	85,5	85,5	85,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	16,3	112,6	112,7	112,7	112,6	112,5	112,4	112,9	112,7	112,8	113,9	114,0	114,3	115,2
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	10,0	103,9	104,0	104,1	104,1	104,2	104,1	104,0	103,9	104,0	103,7	103,4	103,6	103,4
6	Shëndeti	3,4	123,6	123,6	123,6	123,6	123,6	123,6	123,4	122,3	121,7	121,9	121,9	121,9	121,7
7	Transporti	6,1	119,3	118,7	118,5	118,4	118,9	119,1	118,8	118,7	119,2	118,5	118,3	118,0	117,9
8	Komunikimi	2,6	82,3	82,3	82,3	82,3	82,3	82,2	82,2	82,2	82,2	82,3	79,9	79,9	79,9
9	Argëtim dhe kulturë	3,1	114,9	114,8	114,6	114,4	114,4	114,4	114,5	114,6	115,0	115,3	115,0	114,8	114,7
10	Shërbimi arsimor	1,4	109,0	108,9	108,9	108,9	108,9	108,9	109,3	109,3	109,3	109,1	109,0	109,0	109,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,2	108,8	108,9	109,0	108,9	109,0	109,1	109,5	109,6	110,2	110,8	110,9	110,9	110,9
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,9	108,6	110,5	110,7	105,6	105,6	108,4	107,9	107,1	107,5	107,0	112,2	111,9	112,2

Tab. 2 . Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	12-12	01-13	02-13	03-13	04-13	05-13	06-13	07-13	08-13	09-13	10-13	11-13	12-13
Gjithsej		0,9	1,0	1,1	0,3	-0,1	-1,0	-0,6	-0,8	-0,1	0,8	0,1	-0,5	1,7
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,4	2,2	2,6	1,2	-0,4	-2,5	-1,4	-1,7	-0,4	1,6	-0,1	-1,4	3,8
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,3	-0,1	0,3	0,0	-0,1	0,6	-0,2	0,0	-0,2	0,1	0,3	2,2	1,3
3	Veshje dhe këpucë	-0,2	-0,8	-0,6	-0,3	-0,1	-0,4	-1,2	-0,9	-0,2	0,3	0,4	0,0	0,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,0	0,1	0,0	-0,2	0,0	-0,1	0,4	-0,1	0,1	0,9	0,2	0,3	0,8
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,3	0,1	0,1	0,0	0,1	0,0	-0,1	-0,1	0,1	-0,3	-0,2	0,1	-0,1
6	Shëndeti	-0,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	-1,0	-0,4	0,1	0,0	0,0	-0,1
7	Transporti	0,1	-0,6	-0,1	-0,1	0,4	0,1	-0,3	-0,1	0,5	-0,6	-0,1	-0,2	-0,1
8	Komunikimi	1,5	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	-2,9	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,2	-0,1	-0,1	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,1	0,3	0,3	-0,3	-0,2	-0,1
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	-0,2	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,6	0,1	0,1	0,0	0,1	0,1	0,4	0,0	0,6	0,5	0,1	0,0	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-4,2	1,8	0,1	-4,6	0,0	2,6	-0,4	-0,8	0,4	-0,5	4,9	-0,2	0,2

Tab. 3 Ndryshimet vjetore te indeksit

Kodi	Grupet	12-12/12-12	01-13/01-12	02-13/02-12	03-13/03-12	04-13/04-12	05-13/05-12	06-13/06-12	07-13/07-12	08-13/08-12	09-13/09-12	10-13/10-12	11-13/11-12	12-13/12-12
	Gjithsej	2,4	2,7	2,5	2,4	2,3	2,1	2,3	1,6	1,2	1,7	1,7	1,0	1,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,6	4,4	4,9	5,6	5,7	4,9	5,4	4,0	2,8	3,9	3,5	2,1	3,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,8	3,8	3,9	3,6	3,5	4,3	4,1	4,1	3,9	2,4	1,2	3,2	4,2
3	Veshje dhe këpucë	-2,3	-3,1	-3,2	-3,4	-3,4	-3,6	-4,5	-4,4	-3,8	-3,7	-3,8	-3,7	-3,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,3	0,3	-0,1	-0,5	-0,9	-1,0	-0,5	-0,5	-0,5	1,5	1,6	1,5	2,3
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,5	1,3	1,4	1,3	1,2	0,7	0,5	0,4	0,5	0,2	-0,1	-0,1	-0,5
6	Shëndeti	1,5	1,4	1,1	1,1	0,1	0,1	-0,1	-1,0	-1,5	-1,4	-1,5	-1,6	-1,5
7	Transporti	3,4	1,5	0,6	-0,7	-0,3	0,5	1,1	0,5	0,3	-0,9	-1,0	-1,0	-1,2
8	Komunikimi	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,2	1,3	1,3	-1,4	-1,4	-2,9
9	Argëtim dhe kulturë	1,9	1,7	1,5	0,8	0,3	0,4	0,4	0,9	0,8	0,6	0,4	0,1	-0,2
10	Shërbimi arsimor	1,9	1,8	1,8	1,8	1,8	1,8	2,2	2,2	2,2	2,0	0,1	0,1	0,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,0	1,9	1,9	1,7	1,8	1,5	1,9	2,1	2,7	3,1	3,0	2,5	1,9
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,7	7,5	1,4	-3,5	-3,6	-1,0	-1,6	-2,4	-2,0	-3,0	1,8	-1,2	3,3

%

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), duke filluar nga muaji Dhjetor 2007 do të llogaritet me shportën e re të artikujve. Peshat e artikujve janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjes, realizuar nga INSTAT gjatë periudhës Tetor 2006-Shtator 2007. Muaji Dhjetor 2007 do të shërbejë si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2007 = 100). Ndryshimi i mëparshëm i shportës së artikujve është bërë në muajin Janar të vitit 2002, ku numri total i artikujve u rrit nga 221 në vitin 1993 në 262 artikuj. Në shportën e re numri total i artikujve është 272. Indeksi i ri do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet duke përdorur strukturën e Klasifikimit të Shpenzimeve sipas Qëllimit (COICOP) me 12 grupe kryesore, tërësisht të përputhshëm me klasifikimin e shpenzimeve që përdor EUROSTAT.

Indeksi i ri do të mbulojë gjithë territorin e vendit (urban-rural) në ndryshim nga indeksi i mëparshëm që llogaritej vetëm për zonën urbane. Peshat e artikujve do të llogariten të veçanta për çdo prefekturë. Çmimet e artikujve do të mbliidhen në 11 qytetet-prefekturë, ku prefektura Kukës do të përfaqësohet nga prefektura Dibër. Çdo artikull i shportës do të përfaqësohet në indeks me peshën e tij gjeografike. Indeksi i ri do të vazhdojë të publikohet vetëm në nivel kombëtar.

Për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Shqipëri përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0,i}^t = \frac{\sum_i P_i^t * Q_i^0}{\sum_i P_i^0 * Q_i^0}$$

Peshat ($w = P*Q$) e periudhës bazë janë përdorur për llogaritjen e indeksit:

$$I_{0,i}^t = \sum_i w_i * \left(\frac{P_i^t}{P_i^0} \right)$$

Në mënyrë më të detajuar, çmimi relativ është llogaritur për çdo produkt dhe çdo prefekturë duke përdorur mesataren gjeometrike :

$$PR_{t-1,ij}^t = \prod_{k=1}^n \left(\frac{P_{ijk}^t}{P_{ijk}^{t-1}} \right)^{1/n}$$

Ndryshimet mujore zinxhir japin çmimet relative krahasuar me periudhën bazë:

$$PR_{0,ij}^t = PR_{0,ij}^1 * \dots * PR_{t-1,ij}^t$$

IÇK rajonale llogaritet si më poshtë.

$$RIÇKI_{i,0}^t = \sum_i r_{ij} * PR_{0,ij}^t$$

Çmimet relative agregohen me peshat gjeografike për të formuar indekset e çdo produkti për gjithë Shqipërinë.

$$I_{0,i}^t = \sum_j r_{ij} * PR_{0,ij}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_j r_{ij} = 1 \quad : \quad \forall_i \text{ (për të gjitha rastet)}$$

Agregimi për të gjitha produktet jep IÇK e Shqipërisë:

$$CPI_0^t = \sum_i w_i * I_{0,i}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_i w_i = 1$$

Legjenda:

P	çmimi
PR	çmimi relativ
I	indeksi
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
t	periudha korente t
t=0	periudha bazë 0
r	peshat gjeografike
ë	peshat e produkteve
j	numri i prefekturave
i	numri i produkteve

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.